

DR. ABDULLAH NABOLLI

BETIMET

NË KËNDVËSHTRIMIN ISLAM

-Studim akademik-

BETIMET

NË

KËNDVËSHTRIMIN ISLAM

- Studim akademik -

DR. ABDULLAH NABOLLI



Titulli i librit
“BETIMET NË KËNDVËSHTRIMIN ISLAM”
- *Studim akademik* -

Autor
Dr. Abdullah NABOLLI

Redaktor fetar
Teuta XEKA

Redaktimi gjuhësor
Sara FAHEM

Ballina & Faqosja
Pelegrini



Botimi i parë, Tiranë, 2020
© Qendra Kulturore Fetare “Udha e Besimtarëve”
www.udhaebesimtarëve.com

TRYEZA E LËNDËS

PARATHËNIE	5
------------	---

ÇFARË JANË BETIMET?	7
---------------------	---

BETIMET PARA ISLAMIT	9
----------------------	---

<i>Betimi në Zot</i>	9
----------------------	---

<i>Betimi në idhuj</i>	10
------------------------	----

<i>Betimi në gjëra me rëndësi fetare si Qabeja</i>	11
--	----

<i>Betimi në njerëz dhe në gjëra të shtrenjta</i>	11
---	----

<i>Betimi në cilësi me vlerë si amaneti</i>	13
---	----

BETIMET PAS ARDHJES SË ISLAMIT	15
--------------------------------	----

1 RREGULLI I PARË:	
NUK LEJOHET BETIMI VEÇSE NË ZOT	17

<i>Si duhet të jetë betimi në lidhje me gjërat me rëndësi fetare dhe ato me rëndësi jetësore?</i>	18
---	----

<i>Betimet e ndaluara, kur rrëshqet goja</i>	20
--	----

<i>A lejohet betimi në cilësitë e Allahut?</i>	21
--	----

<i>A lejohet betimi mbi Mus'haf?</i>	22
--------------------------------------	----

2 | RREGULLI I DYTË: **MOS U BETO, VEÇSE PËR TË VËRTETA!** 24

Pasojat e betimeve të rreme 26

Ndikimi i kohës në betimin e rreme 31

Përgjegjësia e besimtarit kur dëgjon betimin në Zot 33

3 | RREGULLI I TRETË: **BETIMET DUHEN RUAJTUR** 35

*Nuk ka përgjegjësi para Allahut
për betimet e paqëllimta* 36

Betimet e qëllimta duhen ruajtur 37

Mënyra e shlyerjes së betimeve të qëllimta 42

A kërkohet ruajtje për betimet e shirkut? 44

4 | RREGULLI I KATËRT: **PËRMBUSHJA E BETIMEVE TË KËRKESAVE** 46

SHQIPTARËT DHE BETIMET 48

Betimet e pastra 48

Betimet e shirkut 50

Çfarë kërkohet prej shqiptarëve? 59

PSE KJO TEMË? 61

PARATHËNIE

Lëvdatat i takojnë vetëm Allahut të madhëruar. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi profetin e tij të fundit, Muhamedin alejhis- selam!

Betimet janë të shpeshta në jetën e njerëzve dhe zënë një vend të rëndësishëm në bisedat dhe komunikimet e tyre. Ata i përdorin ato, kur përcjellin lajme, kur japin premtime dhe kur kërkojnë ndonjë gjë me ngulm. Nevoja për to shfaqet nga pamundësia e tyre për ta vërtetuar me fakte çdo lajm që përcjellin, nga domosdoshmëria për pasjen e një sigurie në mbajtjen e premtimit dhe mosshkeljen e tij dhe nga dëshira që kërkesat të merren në konsideratë nga të tjerët.

Njerëzit për të arritur këtë qëllim përmendin emra të ndryshëm prej të shenjtëve dhe të shtrenjtëve të tyre, çfarë e bën këtë çështje të ketë lidhje me **Akiden** (besimi dhe feja). Pastaj nga ana praktike ka prej njerëzve që i vlerësojnë betimet e tyre dhe i ruajnë ato, siç edhe ka të tjerë që i shkelin ato. Disa prej atyre që i vlerësojnë, shpesh herë interesohen nëse mund të lirohesh nga betimi, apo duhet mbajtur me patjetër. Disa të tjerë prej atyre që tregohen të papërgjegjshëm ndaj betimeve, në momentin kur ndërgjegjësohen interesohen për betimet e rreme dhe betimet e shkelura nëse mund të shlyhet përgjegjësia ndaj tyre apo t'i ndreqin, çfarë e bën

këtë çështje të ketë lidhje edhe me **Fik'hun** (ana juridike e çështjeve në Islam). Të gjitha këto e bëjnë të nevojshme të njihemi me domethënien e betimeve në këndvështrimin islam, gjykimin dhe përgjegjësinë e individit ndaj tyre dhe ku qëndron populli ynë në lidhje me to, duke i analizuar edhe nga ana historike, gjë e cila shpeshherë na qartëson shkaqet e përhapjes së disa zakoneve të njerëzve.

Dr. Abdullah Nabolli

ÇFARË JANË BETIMET?

Betimet -siç theksojnë dijetarët- janë shprehje që përmbajnë përforcim veprimesh. Ato në lidhje me emrin e përmendur janë adhurim dhe në lidhje me veprimet që përmbajnë shtojnë përgjegjësinë ndaj tyre. Ata thonë: **“Betim quhet përforcimi i një veprimi duke përmendur një të madhëruar me shprehje të veçanta”**¹.

Me fjalën **“përforcimi i një veprimi”** janë për qëllim tre gjëra: lajmet, premtimet dhe kërkesat. Kjo sepse lajmet që të jenë të besueshme kanë nevojë për vërtetim, premtimet që të mbahen kanë nevojë për garantim, ndërsa kërkesat që të merren në konsideratë kanë nevojë për nxitje².

Me fjalën **“duke përmendur një të madhëruar”** është për qëllim emri i një të adhuruari apo të shtrenjti. Në shoqëritë monoteiste, ato të cilat besojnë në një zot, njerëzit për betim përmendin vetëm emrin e Allahut, Zotit dhe të adhuruarit të tyre të vetëm, ndërsa në shoqëritë idhujtare ata përmendin edhe emra të tjerë si emra të së shenjtëve apo të së shtrenjtëve të tyre.

Me fjalën **“me shprehje të veçanta”** janë për qëllim ato shprehje që përmbajnë madhërim si: Pasha, apo

1 Shih librin El-Mubdi sherh El-Mukni te Ibn Muflih: 8/57.

2 Shih më gjerësisht në librin El-Meusuah El-Fikhije El-Kuejtije: 7/245-246.

betohem, apo zotohem, apo vallahi, bilahi etj. Në këto shprehje përfshihen edhe ato të cilat nuk kanë përmbajtje të drejtpërdrejtë betimi, por nënkuptojnë betime. P.sh: Qafir u bëfsha nëse e bëj atë gjë! Haram e paça bukën nëse nuk e bëj atë gjë! Nëse e bëj atë gjë, gjithë pasuria ime qoftë sadaka!

Shejhu i Islamit Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë çështje thotë: *“Betimet, herë janë në formë të drejtpërdrejtë dhe herë janë në formë ndëshkimi ndaj një veprimi.”* Pastaj thotë: *“Shembulli i kësaj të dytës është shprehja e dikujt: “Nëse e bëj këtë gjë, qofsha jahudij, apo i krishterë, apo dalsha nga islami!”, apo shprehja “Nëse e bëj këtë gjë, qoftë e ndarë gruaja ime!”, apo shprehja “Nëse e bëj këtë gjë, qoftë detyrë për mua haxhi, apo sadaka qoftë e gjithë pasuria ime!”³*

Ai, gjithashtu thotë: *“Angazhimet në emër të Allahut (nedhri) janë forma betimesh. Çdo angazhim është betim. P.sh. shprehja “Për hir të Allahut, detyrë qoftë për mua kjo gjë!”, është si shprehja “Betohem në Zot se do ta bëj këtë gjë!”. Prej të dyja shprehjeve rezulton përfshirje në një punë në emër të Allahut. Argument për këtë është fjala e profetit -alejhi selam-: **Angazhimi në emër të Allahut (nedhri) është betim.**^{4”5}*

Këto janë betimet, domethëniet e tyre dhe shprehjet të cilat i përmbajnë ato dhe janë forma të njohura të njerëzimit në të gjitha kohërat.

3 Shih fjalët e autorit në librin “Mexhmu El-Fetaua”: 35/244.

4 E transmeton imam Ahmedi dhe e saktëson shejh Albani.

5 Shih fjalët e autorit në librin në librin “Mexhmu El-Fetaua”: 35/258.

BETIMET PARA ISLAMIT

Është e rëndësishme të njihemi me gjendjen e arabëve para islamit për të kuptuar më pas gjykimet e islamit, shkaqet dhe rëndësinë e tyre.

Arabët para dërgimit të profetit Muhamed -alejhi selam- kishin fe të përzier: disa zakone i kishin trashëguar nga feja e Ibrahimit -alejhi selam- dhe prej tyre betimi në Allah dhe disa të tjera ishin pjellë e idhujtarisë së shpikur prej tyre pas kohës se Ibrahimit -alejhi selam- dhe prej tyre ishte betimi në idhuj dhe në gjëra të shtrenjta, apo me vlerë për ta.

Duke parë në librat e historisë para islame gjejmë se arabët mes tyre bënë këto lloje betimesh:

Lloji i parë: Betimi në Zot

Hatim Et-Taij, një burrë fisnik arab, i cili i përket kohës para islamit, në poezitë e tij, thoshte:

*Nëse pi derisa te ngopem
me pije dehëse, mos u ngopsha!
Nëse i prish dasmën komshiut,
e të fshihem në errësirë, mos u fsheshsha!
Si ta turpëroj komshijen dhe ta tradhtoj komshiun?!
Jo, pasha Allahun! Sa të jem gjallë, mos e bëfsha!*⁶

6 Shih librin El-Bidaje uen-Nihaje të Ibn Kethirit: 2/ 273.

Në vargun e fundit, poeti betohet në Zot se nuk do t'ia lejojë vetes të bëjë punë të ulëta dhe thotë: Pasha Allahun! Ky adet -siç u tha më lart- është adet i trashëguar nga feja e pastër e Ibrahimit -alejhi selam- me të cilën kanë pasur lidhje arabët dhe bijtë e Izraelit.

Lloji i dytë: Betimi në idhujt si: Lati, Uzaja dhe Menati

Eus bin Haxher, poet i kohës paraislame në një nga poezitë e tij, thoshte:

Pasha Latin dhe Uzanë dhe kush ndjek rrugën e tyre!

Edhe pasha Allahun, sepse Allahu është më i madh prej tyre⁷!

Këto vargje përmbajnë tre betime: dy prej tyre në idhujt dhe i treti në Allahun e madhëruar.

Një poet tjetër i kohës para islame Abdul-Ueza bin Uediah El-Muzenij betohej në Menat dhe thoshte:

Jam betuar me betim prej të singerti,

në Menatin te vendi i fisit të Khazrexhit⁸.

Lati, Uzaja dhe Menati kanë qenë tre idhujt më të mëdhenj të Arabisë të vendosura në tre vendet më të njohura të asaj kohe: Lati në Taif, Uzaja në Mekë dhe Menati në Medine. Arabët, para islamit, i vizitonin ato për mbarësi, siç vizitonin Qaben, bënin Kurban për to dhe u luteshin atyre për nevojat e tyre dhe për shkak të kësaj pozite që kishin tek ata betoheshin në to kur e kishin të nevojshme.

7 Shih librin El-Esnam të Ibn Es-Saib: 17.

8 Shih librin El-Esnam të Ibn Es-Saib: 14.

Lloji i tretë: Betimi në gjëra me rëndësi fetare si Qabeja

Zuhejr bin Ebij Selma, poet shumë i njohur i kohës para islame, saqë poezitë e tij vareshin në Qabe, në një prej këtyre poezive thoshte:

*Betohem ne shtëpinë rreth së cilës tavaf kanë bërë
burrat që e ndërtuan atë prej Kurejshëve dhe Xhurhumit
Ata janë më të mirët fisnikë që janë gjendur,
në çdo gjendje fuqie apo dobësie, janë përgjigjur⁹.*

Në vargun e parë duket qartë betimi në Qabe, sepse ajo është shtëpia e Zotit rreth së cilës bëhej tavaf që nga koha e stërgjyshit të tyre Ibrahimit -alejhi selam- dhe kujdeseshin për të fiset arabe të Kurejshëve dhe të Xhurhumit. Ata prej Ibrahimit -alejhi selam- kishin trashëguar rëndësinë fetare të saj dhe për shkak të kësaj rëndësie betoheshin në të, mirëpo ata me këtë veprim dilyn jashtë zakonit të tij -alejhi selam-, sepse Qabeja ishte caktuar vend për adhurimin e Allahut dhe jo për adhurimin e saj dhe Ibrahimit -alejhi selam- nuk adhuronte asgjë dhe askënd tjetër veç Allahut të madhëruar.

Lloji i katërt: Betimi në njerëz të shtrenjtë si baballarët dhe në gjëra të shtrenjta për jetesën si: kripa, zjarri etj.

Ebu Khirrash El-Hudhelij, poet arab i kohës para islame, por që e ka arritur islamin dhe nga fundi i jetës së tij e ka

9 Shih librin Xhemherat Esh'ar El-Arab të Ibn Ebil-Khattab: 161.

pranuar atë -radiallahu anhu-, në një nga poezitë e tij të kohës së hershme, i drejtohej gruas së tij e cila i kërkonte shkurorëzimin, dhe i thoshte:

*Jo pasha babanë tënd të mirë, (tjetrin)
nuk ke për ta gjetur,
as të sjellshëm kur ka pasuri
dhe as durimtar në varfëri, s'ke për ta hasur¹⁰.*

Në këto vargje kemi një betim të qartë në baballarë -siç ishte adeti i kohës së injorancës-, betim i cili ka vazhduar edhe një farë kohe pas ardhjes së Islamit për shkak se gjuhët e tyre ishin mësuar me këtë lloj betimi¹¹.

10 Shih librin El-Ikhtijarein të El-Ekhfesh El-Esgar: 1/672.

11 Disa dijetarë mendojnë se betimi në baballarë ka vazhduar edhe pas ardhjes së Islamit për shkak se ajo shprehje nuk thuhej më për betim dhe nuk kishte më për qëllim madhërimin e baballarëve. Madje disa prej tyre mendojnë se këtë shprehje e ka përdorur edhe vet profeti -alejhi selam- në një rast kur një bedevi u zotua se do t'i përmbahej shtyllave të islamit. Ata mendojnë se profeti -alejhi selam- në këtë rast ka thënë: **“Pasha babanë e tij, ka për të shpëtuar nëse ai ka thënë të vërtetën.”** e transmeton Muslimi.

Shejh Albani -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë hadith thotë: Shprehja **“Pasha babanë e tij”** nuk është nga fjalët e profetit -alejhi selam-, sepse ky hadith ka ardhur më tekste të tjera të cilat nuk e përmbajnë këtë shprehje si teksti: **“Ka për të shpëtuar nëse ka thënë të vërtetën.”** e transmeton Buhariu dhe Muslimi, apo teksti **“Ka për të shpëtuar, pasha Allahun, nëse ka thënë të vërtetën.”**. Shih fjalët e autorit në librin e tij “Es-Silsile Ed-Daife”: 10/750-768.

Kështu, betimi në baballarë nuk është shprehje e miratuar nga profeti

Një poet tjetër betohej në gjëra të tjera të domosdoshme për jetesën dhe thoshte:

*U betova në kripë kur njerëzit
ishin prezentë në një grumbullim të madh
Dhe u betova në zjarrin dhe në Latin,
sepse ai është më i madh¹².*

Në këto vargje kemi betimin në kripë dhe në zjarr si dy gjëra të shtrenjta për jetesën e njeriut. Kjo nëse ata nuk i adhuronin ato duke i konsideruar zota, siç bënin persët me zjarrin, sepse ashtu kemi të bëjmë me betim në idhuj.

Lloji i pestë: Betimi në cilësi me vlerë si amaneti

Ky lloj betimi është përmendur në një hadith profetik ku profeti -alejhi selam- e kritikon atë dhe thotë: **“Kush betohet në amanet nuk është prej nesh.”**¹³

Nuk dihet mirë se çfarë ka pasur për qëllim profeti -alejhi selam- me fjalën amanet: porositë e Zotit, apo besnikërinë e burrit, sepse kjo fjalë i përmban të dyja.

Muhamed -alejhi selam-, aq më tepër kur ekzistojnë porosi prej tij për të mos u betuar në prindër -siç do të vijë më poshtë- dhe se ajo me shumë gjasa ka vazhduar pas ardhjes së Islamit për shkak se gjuhët ishin mësuar me atë lloj betimi.

12 Shih librin El-Bejan uet-Tebjin të El-Xhahidh: 3/7.

13 E transmeton Ebu Daudi dhe e saktëson shejh Albani.

Dijetari i njohur i gjuhës arabe Ibn El-Ethir -Allahu e mëshiroftë- thotë: *“Me fjalën amanet emërtohen disa gjëra: bindja ndaj urdhrave të zotit, porositë e Allahut (namazi, agjërimi, zekati, haxhi etj), gjërat që lihen për t’u ruajtur në mirëbesim, besnikëria dhe garancia.”*¹⁴

Kështu nëse në hadith është për qëllim besnikëria e burrit, atëherë ai mund të ketë lidhje me ndalimin e betimit në këtë cilësi me vlerë te njerëzit, madje arabët kanë qenë shumë të njohur për të edhe para islamit dhe ata për shkak se e vlerësonin shumë, ndoshta edhe betoheshin në të. E nëse me fjalën amanet janë për qëllim porositë e Zotit, atëherë ai ka të bëjë me myslimanët e jo me arabët para islamit, që ata të mos betohen në porositë e Allahut, sepse Allahu për porositë e Tij nuk ka kërkuar më shumë se respekt dhe bindje.

Këto ishin disa nga betimet e njerëzve para islamit dhe shkaqet tyre. Në vijim do të njihemi me gjykimin e këtyre betimeve në islam dhe rregullat e myslimanëve në lidhje me to.

14 Shih librin e autorit me titull En-Nihaje: 1/71.

BETIMET PAS ARDHJES SË ISLAMIT

Betimi në realitet -siç u tha më lart- është madhërim që i bëhet atij në të cilin betohesh dhe i betuari për hir të tij thotë të vërtetën dhe nuk gënjen, e mban premtimin dhe nuk e shkel atë dhe për hir të tij kërkesat merren në konsideratë. Ky lloj madhërimi në këtë lloj mënyre është adhurim dhe nuk i takon veçse Allahut të madhëruar.

Kur erdhi feja islame me adhurimin e Allahut një, zotit të vetëm të njerëzve si ripërtëritje e besimit të pastër të Ibrahimit -alejhi selam- dhe e profetëve e tjerë të Allahut -alejhim selam- me patjetër që ajo do t'i pastronte edhe shprehjet e njerëzve të cilat binin ndesh me besimin e pastër, prandaj dhe është përmendur se profeti Muhmamed -alejhi selam- ka thënë:

“Mos u betoni as në ata që i kalojnë kufijtë (në idhujt), as në ata që barazohen me Allahun, as në baballarët tuaj dhe as në nënat tuaja! Mos u betoni veçse në Allah!”¹⁵

“Kush betohet në diçka tjetër veç Allahut ka bërë shirk (ortak Zotit). Kush do të betohet, të mos betohet veçse në Zot ose të heshtë!”¹⁶

15 E transmeton Omeri -radiallahu anhu- dhe e përcjell Muslimi dhe Nesai.

16 E transmeton Abdurrahman bin Semura -radiallahu anhu- dhe e përcjell Buhariu, Muslimi, Ibn Maxhe dhe Ahmedi.

Kështu profeti -alejhi selam- i ndaloi të gjitha betimet e kohës para islame duke i cilësuar ato shirk dhe duke mos lënë veçse betimin në Allah siç ishte adeti i profetëve para tij. Pastaj Islami, përveç këtij rregulli, i cili ka të bëjë me mbrojtjen dhe ruajtjen e besimit të pastër solli edhe rregulla apo norma për respektimin e këtyre betimeve duke plotësuar kështu në çdo aspekt këtë fe siç thotë Allahu i madhëruar:

الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا

“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova mirësinë time ndaj jush dhe zgjedha për ju islamin fe”¹⁷.

17 Suratu El-Maide: 3.

1

RREGULLI I PARË: NUK LEJOHET BETIMI VEÇSE NË ZOT

Ky rregull vjen për shkak të asaj që u tha më lart se betimi në dikë a diçka tjetër veç Allahut është shirk (ortakëri në besim). Imam Neveviu -Allahu e mëshiroftë thotë: *“Dijetarët thonë se urtësia e ndalimit të betimeve në dikë tjetër veç Allahut, qëndron te fakti se betimi është madhërim i atij në të cilin betohesh dhe madhërimi në realitet është veçanti e Allahut dhe të tjerët në këtë çështje nuk duhet të ngjasojnë me Të”*¹⁸.

Ky shirk nganjëherë mund të jetë shirk i madh, i cili të nxjerr nga feja e Allahut dhe nganjëherë mund të jetë shirk i vogël, i cili nuk të nxjerr nga feja, por që në të dyja rastet është i ndaluar.

Shejhu i Islamit Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë çështje thotë:

*“Ai (profeti -alejhi selam-) e ka quajtur atë shirk, sepse betimi në dikë tjetër veç Allahut është adhërim dhe kush betohet në dikë tjetër veç Allahut, i ka bërë ortak Allahut. Kush e bën këtë gjë duke besuar në adhërimin e tij (dmth: të atij në të cilin betohet) ai është kafir (mohues), e nëse nuk e beson adhërimin e tij atëherë ai ka bërë shirk në fjalë i cili qëndron më poshtë se shirku i madh i cili të nxjerr nga feja.”*¹⁹

18 Shih fjalët e autorit në librin e tij “Sherh Sahih Muslim”: 11/105.

19 Shih fjalët e autorit në librin e tij: “Xheuab fîj El-Halfi bi gajrilah”: 6.

Pra, ai që betohet në dikë tjetër veç Allahut, nëse në atë që është betuar ka adhurim ndaj tij me dashuri, shpresë, frikë dhe nënshtrim, atëherë betimi i tij është shirk i madh dhe kjo e nxjerr atë nga feja e Allahut, sepse ai kështu i ka bërë ortak Atij. E nëse betimi i tij nuk përmban adhurim të kësaj natyre siç është në shumicën e rasteve betimi në baballarë dhe në gjëra të shtrenjta për jetën e njeriut si: jeta, buka, risku etj., atëherë betimi i tij është fjalë shirku dhe shirk i vogël, i cili nuk të nxjerr nga feja, por gjithsesi është i ndaluar sepse e dobëson dhe e zbeh besimin dhe mbështetjen në Allahun e madhëruar.

Islami, për të ruajtur këtë parim, rregulloi edhe disa forma betimesh të cilat bëheshin në gjëra të shtrenjta me rëndësi fetare apo jetësore, si dhe solli shlyerjen e betimeve të ndaluara kur rrëshqet goja.

Si duhet të jetë betimi në lidhje me gjërat me rëndësi fetare dhe ato me rëndësi jetësore?

Kutejle bintu Sajfij El-Xhuheniye -radiallahu anha- tregon: *“Një prej dijetarëve të hebrenjve erdhi te i dërguari i Allahut dhe i tha: Ju jeni njerëzit më të mirë, sikur të mos bënit shirk! Profeti -alejhi selam- (me habi) i tha: **SubhanAllah! Ku është shirku?** Ai i tha: Ju kur betoheni thoni: **Pasha Qaben!** Atëherë profeti -alejhi selam- u mendua dhe tha: **Kush do të betohet le të thotë: Pasha Zotin e Qabes!**”*²⁰

20 E transmeton Ahmedi, Nesai etj dhe e saktëson shejh Albani.

Hadithi tregon se betimi në dikë tjetër veç Allahut nuk lejohet në asgjë deri dhe në ato që kanë rëndësi të vërtetë fetare. Ai gjithashtu tregon se shprehjet e parregullta, të cilat përmbajnë shirk, duhen ndryshuar siç bëri profeti Muhamed -alejhi selam- me shprehjet e njerëzve të kohës së tij dhe siç kanë bërë të gjithë profetët e Allahut me popujt e tyre përderisa edhe hebrenjtë ishin në dijeni të këtij parimi.

Kjo formë betimi mund të përdoret për çdo gjë tjetër të shtrenjtë si p.sh.: në lidhje me profetin tonë Muhamedin -alejhi selam-, siç bënte Aishja -radiallahu anha-.

Aishja -radiallahu anha- tregon se profeti -alejhi selam- i ka thënë asaj: **“Unë e dalloj, kur ti je kënaqur me mua dhe kur je e zemëruar. I thashë: Si e dallon atë? Ai më tha: Ti kur je e kënaqur thua: Pasha Zotin e Muhamedit! Dhe kur je e zemëruar thua: Pasha Zotin e Ibrahimit!”**²¹

Muhamedi dhe Ibrahim i -alejhima selam- janë dy profetët më të mëdhenj të njerëzimit: i pari si profeti i islamit, fesë sonë të cilën e zgjodhi Allahu i madhëruar për ne dhe i dyti si simbol i njësimi të Zotit një. Kështu, betimi kur do të nxjerrësh në pah rëndësinë e tyre, nuk bëhet duke u betuar në ta, por në Zotin i cili i dërgoi ata dhe thuhet: Pasha Zotin e Muhamedit, apo pasha Zotin e Ibrahimit!

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për betimin në kripë, bukë zjarr, qiell, tokë etj. për ata që e kanë zakon të betohen në to. Ata nëse duan patjetër t'i përmendin ato, atëherë të thonë: Pasha Krijuesin e kësaj kripe, apo pasha Furnizuesin

21 E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

e kësaj buke, apo pasha Zotin që krijoi zjarrin, apo pasha Krijuesin e qiellit dhe të tokës, i cili në të gjitha rastet është Allahu i madhëruar dhe është betim në emrin e Tij xhele sha'nuhu!

Betimet e ndaluara, kur rrëshqet goja

Ndodh shpesh, sidomos tek ata që nuk kanë pjekuri në Islam dhe trashëgojnë nga e hershmja e tyre kulturë jo-islame, që dikush të betohet gabimisht në dikë tjetër veç Allahut të madhëruar. Kjo gjë ndonjëherë ndodhte edhe me sahabët, sepse ata në fillimet e Islamit për shkak se gojë e tyre ishin mësuar me betime në idhuj u rrëshqiste goja dhe betoheshin pa qëllim në Latin dhe Uzanë (dy idhuj të hershëm të Arabisë).

Në lidhje me këtë çështje Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë: **“Kush betohet dhe thotë në betimin e tij (gabimisht): Pasha Latin dhe Uzanë! Le të thotë: La ilahe il-la Allah! (Nuk ka zot që adhurohet veç Allahut).”**²²

Ibn El-Kajimi -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë hadith thotë: *“Kjo gjë është shlyerje për gabimin e tij, sepse profeti -alejhi selam- ka thënë se kush betohet në dikë tjetër veç Allahut ka bërë shirk dhe shlyerja e shirkut është njësimi i Allahut i cili është në fjalën La ilahe il-la Allah.”*²³

22 E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

23 Shih librin e autorit me titull El-Uabil Es-Sajjib: 141.

A lejohet betimi në cilësitë e Allahut?

Betimi në Zot përfshinë edhe emrat, edhe cilësitë e tij që do të thotë se në betimin tënd mund të përmendesh: ose një emër të Zotit, ose një cilësi të Tij.

P.sh.: mund të thuash: Pasha Gjithëdijshmin! Dhe mund të thuash edhe: Pasha dijen e Allahut!

Betimi i parë është në një prej emrave të Allahut dhe që është i Gjithëdijshmi, kurse betimi i dytë është në dijen si cilësi e Allahut duke ia referuar atë emrit të Tij.

Shejhu i Islamit Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë çështje thotë:

“Dihet, se ai që betohet në cilësitë e Tij (d.m.th: në cilësitë e Allahut të madhëruar) është sikur të jetë betuar në të (d.m.th: në Allahun e madhëruar), kur dikush thotë: Pasha krenarinë e Allahut, apo pasha jetën e Allahut, apo pasha Kuranin famëlartë. Kjo, sepse është saktësuar lejimi i betimit në cilësitë e Tij nga profeti -alejhi salam- dhe sahabët -radiallahu anhum- dhe se betimi në cilësitë e Tij është si kërkimi i mbrojtjes prej tyre. E nëse kërkimi i mbrojtjes nuk i bëhet veçse Allahut të madhëruar në fjalët e profetit -alejhi salam- kur thoshte: Kërkoj mbrojtjen e fytyrës tënde, apo kërkoj mbrojtjen e fjalëve të tua të përsosura, apo kërkoj mbrojtjen e kënaqësisë tënde prej zemërimit tënd etj., atëherë kështu është edhe betimi në to dhe kjo çështje është miratuar nga dijetarët.”²⁴

24 Shih fjalët e autorit në librin El-Fetaua El-Kubra: 4/130.

Ndërsa në një citat tjetër thotë: *“Nuk lejohet betimi veçse në emrat e Allahut, apo në një prej cilësive të Tij.”*²⁵

A lejohet betimi në Mus'haf?

S'ka dyshim se betimi në Kuranin famëlartë lejohet, sepse Kurani është fjala e Allahut të madhëruar dhe fjala e Tij është cilësi e Tij, ndërsa betimi në Mus'haf -kështu quhet libri ku është shkruar Kurani- ndryshon. Kjo sepse fjala Mus'haf përmban dy gjëra:

E para: Fletët, boja dhe kapakët të cilat janë gjëra të krijuara dhe nuk lejohet betimi në to.

E dyta: Fjalët e Kuranit të cilat janë fjalët e Allahut dhe ajo është cilësi e Tij dhe betimi në cilësitë e Tij lejohet.

Shejh El-Albani -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë çështje thotë: *“Ai i cili betohet në Mus'haf është betuar edhe në gjë të lejuar edhe në gjë të ndaluar. Kjo përzierje nuk lejohet dhe në rast se duam ta saktësojmë atë, atëherë mund të themi: Betohem në fjalën e Allahut e cila gjendet në këtë Mus'haf! Kështu betimi në këtë formë bëhet i lejueshëm.”*²⁶

Ky është rregulli i parë i Islamit në lidhje me betimet dhe lusim Allahun e madhëruar të na ruaj zemrat tona dhe gjuhët tona nga shirku dhe idhujtaria, sepse siç thotë Allahu i madhëruar në Kuran:

25 Shih fjalët e autorit në librin Muhtesar El-Fetaua El-Misrije: 1/548.

26 Shih fjalët e autorit në kasetat e tij me titull El-Muteferrikat. Kasetat nr: 233.

إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ

“Shirku (ortakëria në besim) është padrejtësia më e madhe.”²⁷

që do të thotë: padrejtësia më e madhe e cila i bëhet Allahut zotit të botëve; është kur dikë a diçka prej krijesave të Tij e krahasojnë me Të, prandaj betimi në to është një prej shfaqjeve të idhujtarisë apo ortakërisë në besim.

²⁷ Suretu El-Lukman: 13.

2

RREGULLI I DYTË: MOS U BETO, VEÇSE PËR TË VËRTETA!

Ky rregull ka lidhje me ato betime të cilat bëhen për të vërtetuar: fjalët, lajmet, deklaratat, dëshmitë etj. dhe betimet në raste të tilla nuk duhen bërë vetëm se kur ato janë të vërteta.

Profeti -alejhi selam- thotë:

“Ai i cili betohet në Allah, të thotë vërtetën!”²⁸

Dhe gjithashtu thotë:

“Mos u betoni në Allah, veçse kur thoni të vërtetën!”²⁹

Kjo, sepse betimet janë madhërime që i bëhen emrit të Allahut dhe besimtari kur përmend emrin e Tij duhet të thotë gjithmonë të vërtetën.

Porositë e Allahut të madhëruar dhe të profetëve të Tij gjithmonë kanë qenë që njeriu të thotë të vërtetën dhe e kanë ndaluar atë nga gënjeshtria si domosdoshmëri e jetës në tokë, sepse në një shoqëri ku të gjithë gënjejnë dhe nuk thonë të vërtetën, jeta në tokë bëhet e vështirë. Kështu njeriu aq më tepër duhet të thotë të vërtetën kur betohet në Zotin e tij, sepse kjo prek jetën e tij në dy aspekte kryesore: në aspektin e besimit dhe në aspektin e marrëdhënieve me të tjerët.

²⁸ E transmeton Ibn Maxhe dhe e saktëson shejh Albani.

²⁹ E transmeton Ebu Daudi, Nesai dhe e saktëson shejh Albani.

E prek atë në aspektin e besimin, sepse ai duke u betuar me betime të rreme ka nënçmuar Zotin e tij duke mos e vlerësuar emrin e Tij siç e meriton të vlerësohet.

Dhe e prek atë në aspektin e marrëdhënieve me të tjerët, sepse njerëzit zakonisht e respektojnë emrin e Zotit të tyre, kur Ai përmendet dhe kështu i betuari me betime të rreme merr prej tyre atë që nuk i takon, apo bëhet shkak që dikush të marrë prej tyre atë që nuk i takon, etj..

Në lidhje me këtë të fundit profeti -alejhi salam- ka gjykuar se ky veprim është prej gjynaheve të mëdha.

Abdullah bin Amr bin El-As -radiallahu anhu- tregon:

“Një banor i shkretëtirës erdhi te profeti -alejhi salam- dhe e pyeti: Cilat janë gjynahet e mëdha?”

*Profeti -alejhi salam- iu përgjigj: **Ti bësh ortak Allahut.***

Burri i tha: Po pastaj?

*Profeti -alejhi salam- i tha: **Pastaj keqtrajtimi i prindërve.***

Burri i tha: Po pastaj?

*Profeti -alejhi salam- i tha: **Pastaj betimi zhytës.***

E pyeta: Ç’do të thotë betim zhytës?

*Profeti -alejhi salam- më tha: **Ai betim me të cilin i merret një pasuri ndonjë myslimani kur i betuari ka gënjyer.***”³⁰

Fjala e profetit -alejhi salam- “**betimi zhytës**”, Ibn Haxheri (komentuesi i njohur i haditheve -Allahu e mëshiroftë-) në lidhje me këtë, thotë: “*Është thënë se ky*

30 E transmeton Buhariu.

betim është quajtur me këtë emër, sepse ai e zhyt atë që betohet në gjynah, pastaj e zhyt atë në zjarrin e xhehenemit.”³¹

Ky lloj betimi, nuk përfshin vetem rastin kur do t'i marrësh një pasuri dikujt me pa të drejtë, sepse dijetarët e islamit në lidhje me të thonë: *Betimi zhytës është kur betohesh me betim të rremë duke e ditur atë, ose për të kënaqur dikë, ose për t'u shfajësuar para dikujt, ose për t'i marrë diçka dikujt etj.*³²

Pra, ky lloj betimi përfshinë të gjitha rastet kur i betuari betohet me betim të rremë dhe e përdor betimin e tij për të përfituar diçka me pa të drejtë nga çështjet e dynjasë.

Pasojat e betimeve të rreme kur përdoren për të fituar diçka me pa të drejtë

Betimi i rremë në raste të tilla është me pasoja të rënda për atë që është betuar edhe në dynja edhe në ahiret.

Për sa i përket dynjasë, pasojat e betimeve të rreme janë dënim për atë që është betuar dhe shërim i zemrës së atij që i është cënuar e drejta.

Profeti -alejhi selam- në lidhje me këto betime, thotë: **“Betimet zhytëse i lënë shtëpitë bosh.”³³**

31 Shih fjalët e autorit në librin Fet'h El-Barij: 11/555.

32 Shih librin sherh El-Buharij të Ibn Batalit: 6/130, Sherh El-Buharij të Ibn Mulekin: 30/319 dhe Sherh El-Buharij të El-Ajnij: 23/193.

33 E transmeton Bejhakui dhe e saktëson sheijh Albani.

Fjala “**Bosh**” d.m.th. pa njerëz dhe pa begati³⁴ që të kënaqet ai të cilit i është bërë padrejtësia. Ja një ngjarje e vërtetë e treguar nga Ibn Abasi -radiallahu anhu- e cila vërteton në praktikë hadithin e profetit -alejhi selam-.

Ibn Abasi -radiallahu anhu- tregon:

“I pari betim i bërë në lidhje me një gjak në kohën e injorancës (dmth: ajo paraislame) ka lidhje me ne bijtë e Hashimit (emri i gjyshit të tyre dhe emri i fisit të afërt të profetit -alejhi selam-).

Një burrë prej bijve të Hashimit shkoi të punojë qiraxhi te një kurejshit i një barku tjetër (dmth: rrjedh nga një degëzim tjetër i Kurejshëve). Ai doli me të dhe me devetë e tij dhe pranë tyre kaloi një burrë tjetër nga bijtë e Hashimit të cilit i ishte këputur lidhësja e torbës.

Burri iu lut atij: Më ndihmo me një lak, të shtrëngoq mbajtësen e torbës që të mos më trembet deveja!

Ai ia dha lakun dhe ai shtrëngoi me të torbën dhe iku.

Kur ata qëndruan për të pushuar, i lidhën devetë me leqe me përjashtim të njëres dhe pronari i tha atij: Si është puna e kësaj deveje e cila nuk është lidhur si të tjerat?

Ai i tha: Nuk ka lak.

Pronari i tha: Ku është laku i saj?! Dhe i gjuajti atij me shkop, gjuajtje e cila do t'i shkaktonte vdekjen (dhe u largua).

34 Shih komentimin e hadithit të El-Mula Alij El-Karij në librin “Sherh Musned Ebij Hanife”: 1/536 dhe komentimin e El-Menauj në librin “Fejd El-Kadir”: 5/365.

*Aty më pas kaloi një burrë nga Jemeni dhe ai e pyeti atë:
A do të prezantosh në haxh?*

Burri i tha: Jo nuk do të prezantoj, por edhe mundet.

Ai i tha: A do të ma përcjellësh një porosi, kur të mundesh?

Burri i tha: Po.

Atëherë ai i diktoi dhe i tha: Kur të prezantosh në haxh, thirr: O Kurejsh! Kur ata të përgjigjen, thirr: O bijtë e Hashimit! Kur ata të përgjigjen, pyet për Ebu Talibin dhe njoftoje se filani më ka vlarë për një lak! Dhe vdiq.

Kur u kthye pronari i cili e kishte marrë atë në punë, shkoi Ebu Talibi dhe e pyeti: Çfarë i ka ngjarë të afërmit tonë?

Ai i tha: U sëmur dhe vdiq. Jam kujdesur shumë mirë për të dhe e kam varrosur vetë me duart e mia.

Ebu Talibi në shenjë mirënjohje i tha: Kështu e prisja prej teje!

Pas një farë kohe vjen burri të cilin e kishte porositur për të përcjellë lajmin e tij dhe qëllon kohë haxhi. Ai thirri: O Kurejsh! Dhe njerëzit i thanë: Ja ku janë Kurejshët! Pastaj thirri: O bijtë e Hashimit! Njerëzit i thanë: Ja ku janë bijtë e Hashimit! Pastaj pyeti: Ku është Ebu Talibi? Njerëzit i thanë: Ky është Ebu Talibi! Dhe ai i tha atij: Filani më ka porositur të të përcjell një porosi se filani e ka vlarë atë për një lak.

Atëherë Ebu Talibi shkoi dhe i tha atij (vrasësit): Zgjidh njërën prej tre gjërave: ose na jep njëqind deve si shpagim, sepse ke vlarë të afërmin tonë, ose në daç të betohen pesëdhjetë burra nga të afërmit e tu se ti nuk e ke vlarë, e nëse refuzon do të të vrasim për të.

Burri shkoi tek të afërmit e tij dhe ata i thanë: Do të betohemi.

Një grua prej bijve të Hashimit e cila ishte e martuar me njërin prej tyre dhe i kishte lindur atij një fëmijë, shkoi te Ebu Talibi dhe i tha: O Ebu Talib, kërkoj për hir të djalit tim ta heqësh nga betimi një burrë prej të pesëdhjetëve dhe të mos i kërkohet betimi te vendi i betimit! Dhe ai e pranoi. Pastaj erdhi një burrë prej tyre dhe i tha: O Ebu Talib, kërkoje pesëdhjetë burra për t'u betuar në vend të njëqind deveve dhe secilit prej nesh i takojnë dy deve. Ja ku i ke dy deve dhe pranoji ato prej meje dhe mos më kërko të betohem te vendi i betimit! Dhe ai ia pranoi. Pastaj erdhën dyzet e tetë veta dhe u betuan.

Ibn Abasi thotë: Pasha atë që në dorën e tij është shpirti im, nuk kaloi viti dhe ndonjëri prej dyzet e tetëve të lëvizte sytë.”³⁵

Fjala e tij [të lëvizte sytë] do të thotë se ndëshkimi i tyre ishte i fortë dhe i shpejtë, Allahu na ruajt prej zemërimit të Tij!

Ndërsa në lidhje me pasojat e betimeve të rreme në ahiret profeti -alejhi salam- në një hadith, thotë:

“Ai i cili betohet me betim pengimi për t'i marrë një pasuri ndonjë myslimani dhe ai gënjen, ka për ta takuar Allahun të zemëruar me të.”³⁶

Detajet e këtij zemërimi janë përmendur në Kuran, ku thuhet:

35 E transmeton Buhariu.

36 E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

إِنَّ الَّذِينَ يَسْتُرُونَ بِعَهْدِ اللَّهِ وَأَيْمَانِهِمْ ثَمَنًا قَلِيلًا أُولَٰئِكَ لَا خَلَاقَ لَهُمْ فِي الْآخِرَةِ
وَلَا يُكَلِّمُهُمُ اللَّهُ وَلَا يَنْظُرُ إِلَيْهِمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَلَا يُزَكِّيهِمْ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ

“Vërtet, ata që e shkëmbejnë premtimin dhe betimin e tyre ndaj Allahut me një vlerë të vogël, nuk do të kenë asnjë të mirë në jetën e ardhshme. Allahu nuk do t’u flasë atyre, as nuk do t’i shikojë ata Ditën e Kiametit dhe as nuk do t’i pastrojë ata prej gjynaheve e për ta do të ketë dënim të dhembshëm”³⁷.

Pra zemërimi i Allahut me ata për këtë veprim do të jetë shkak që Allahu, as të mos i bëjë atyre pjesë në ahiret, as të shohë drejt tyre për mëshirim dhe as t’i pastrojë ata nga gjynahu ku janë zhytur dhe në fund t’i dënojë ata në zjarrin e xhehenemit.

Ky gjynah te shumica e dijetarëve është i pashlyeshëm që do të thotë se sheriatu nuk ka caktuar ndonjë punë për shlyerjen e tij me përjashtim të pendimit të sinqertë për të mos e përsëritur më atë veprim dhe duke iu kthyer robve të Allahut të drejtat e tyre.

El-Esh’ath bin Kajs El-Kindij -radiallahu anhu- në lidhje me këtë ajet tregon:

“Ky ajet ka zbritur për mua. U grinda njëherë me një burrë te profeti -alejhi selam- në lidhje me një burim uji i cili ishte

37 Suretu Ali-Imran: 77.

*i imi, por që e përdorte ai. Ai ma mohoi të drejtën time dhe profeti -alejhi salam- më tha: **Sill fakte që ai burim është i yti, ose përndryshe të betohet ai tjetri!** Dhe më tha: **A ke fakte?** Unë i thash: Jo, o i dërguari i Allahut! Atëherë profeti -alejhi salam- tha: **Të betohet tjetri.** I thashë: O, i dërguari i Allahut! Ç'më duhet mua betimi i tij? Nëse do të gjykoshe me betimin e tij, do të ma marrë burimin. Kundërshtari im është burrë i poshtër. Nuk e vret mendjen se për çfarë betohet dhe as e vret ndërgjegjja për ndonjë gjë. Profeti -alejhi salam- më tha: **Nuk të takon gjë tjetër veç betimit të tij.** Burri u bë gati për t'u betuar dhe kur u ngrit për ta bërë, profeti -alejhi salam- tha: **Nëse do t'ia marrë atij burimin me pa të drejtë me betim të rremë do të jetë prej atyre të cilët nuk do t'i shohë Allahu ditën e kiametit dhe as nuk do t'i pastrojë prej gjynaheve e për ta do të ketë dënim të dhembshëm.** Kështu Allahu e zbriti ajetin dhe burrin filloi ta vriste ndërgjegjja. Ai iu drejtua profetit -alejhi salam- dhe i tha: Çfarë ka për atë që e lë atë? Profeti -alejhi salam- i tha: **Ka xhenetin.** Atëherë burri i tha: Dëshmoj se ia kam lënë të gjithin atij.³⁸*

Ndikimi i kohës në betimin e rremë

Koha ndikon shpeshherë në rëndimin e gjynaheve siç ndikon edhe vendi ku kryhen. Jemi njoftuar nga profeti -alejhi salam- se prej atyre të cilëve nuk do t'u flasë

38 E transmeton Buhariu, Muslimi, Ebu Daudi dhe Ahmedi.

Allahu ditën e kiametit, as do të shohë tek ata, as do t'i pastrojë ata nga gjynahet dhe për ta do të ketë dënim të dhembshëm, është edhe: **“Një burrë që bën pazar me dikë për një mall pas ikindisë (koha e pasdites para perëndimit të diellit) dhe i betohet atij në Allah se e ka marrë atë me kaq e aq (dhe një transmetim tjetër: i kanë dhënë për të kaq e aq) dhe ai ia beson ndërkohë që e vërteta është ndryshe.”**³⁹

Komentuesi i njohur Ibn Battal -Allahu e mëshiroftë- në komentimin e hadithit thotë: *“Hadithi tregon se kjo kohë është kohë në të cilën gjynahet rëndojnë më shumë, sepse në atë kohë ngjiten melaiket me punët e robëve të Allahut i madhëruar dhe ata e konsiderojnë të madhe të ngjiten prej robit me ndonjë gjynah që të jetë shpërblimi i tij sipas punës së fundit që ka kryer.”*⁴⁰

Për shkak të këtij realiteti që përcjell komentuesi i njohur i haditheve në lidhje me këtë kohë, të gjithë ymetet që kanë njohur ligjet e Allahut e kanë vlerësuar atë dhe njeriu duhet të jetë i kujdesshëm për të mos e nënvlerësuar me punën e tij të keqe atë që e ka vlerësuar Allahu i madhëruar dhe besimtarët e Tij brez pas brezi.

39 E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

40 Shih fjalët e autorit në shpjegimin e tij të Buhariut: 6/500.

Përgjegjësia e besimtarit kur dëgjon betimin në Zot

Betimet ngarkojnë me përgjegjësi në raste akuzash jo vetëm atë që betohet, por edhe kundërshtarit e tij kur nuk ka fakte për vërtetimin e të drejtës së tij. Përgjegjësia e atij që betohet është siç u tha më lart, ose të thotë të vërtetën, ose në të kundërtën do të ketë zemërimin e Allahut, ndërsa përgjegjësia e kundërshtarit është ta pranojë betimin e tij dhe t'ia dorëzojë çështjen e Tij Allahut të madhëruar.

Profeti -alejhi salam- thotë: **“Kur dikush të betohet në Allah, pranoje atë, se kush nuk mjaftohet me Allahun nuk është prej Tij.”**⁴¹

Es-Sindij komentuesi i njohur i haditheve të Ibn Maxhes -Allahu e mëshiroftë- thotë: *“Kuptimi i tij është se ata që janë të afërt me Allahun e besojnë betimin e atij që betohet në Allah dhe kjo për shkak të madhërimit që kanë për Të dhe ai që nuk e bën këtë punë duke e pasur mundësinë, nuk është prej tyre.”*⁴²

Ja si e ka zbatuar këtë një prej profetëve të Allahut Isai -alejhi salam- siç e tregon profeti ynë -alejhi salam-: **“Isai i biri i Merjemes pa një burrë duke vjedhur dhe i tha: Po vjedh? Ai iu përgjigj: Jo, pasha Atë të cilin nuk ka zot tjetër veç Tij! Atëherë Isai tha: I besoj Allahut dhe përgënjeshtroj sytë e mi.”**⁴³

41 E transmeton Ibn Maxhe dhe e saktëson shejh Albani.

42 Shih librin Hashijet Es-Sindij ala Ibn Maxhe: 1/646.

43 E transmeton Ibn Maxhe dhe e saktëson shejh Albani.

Kështu duhet të jetë reagimi i besimtarëve kur përmendet emri i Allahut, zotit të tyre duke e lënë çështjen e tyre në dorën e Tij, i cili është gjykuesi më i drejtë dhe hakmarrësi më i mirë dhe më i shpejtë.

Së fundi: Lusim Allahun e madhëruar të na bëjë prej atyre që i vlerësojnë betimet, duke thënë gjithmonë të vërtetën, sepse betimet janë madhërime të emrit të Tij dhe pasqyrë e devotshmërisë së zemrave të besimtarëve. Amin!

3

RREGULLI I TRETË: BETIMET DUHEN RUAJTUR

Ky rregull ka lidhje me ato betime të cilat nuk përmbajnë njoftime, por përmbajnë premtime në emër të Allahut të madhëruar. Për shembull, kur dikush thotë: Pasha Allahun do ta bëj këtë gjë, apo pasha Allahun nuk do ta bëj atë gjë!

Gjykimi i këtyre betimeve është se ato duhen ruajtur, veçse nëse janë të paqëllimta, siç thotë Allahu i madhëruar në Kuran:

لَا يُؤَاخِذُكُمُ اللَّهُ بِاللَّغْوِ فِي أَيْمَانِكُمْ وَلَكِنْ يُؤَاخِذُكُمْ بِمَا عَقَّدْتُمُ الْأَيْمَانَ فَكَفَّارَتُهُ إِطْعَامُ عَشْرَةِ مَسَاكِينَ مِنْ أَوْسَطِ مَا تُطْعَمُونَ أَوْ هَلِيكُمُ أَوْ كِسْوَتُهُمْ أَوْ تَحْرِيرُ رَقَبَةٍ فَمَنْ لَمْ يَجِدْ فَصِيَامُ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ ذَلِكَ كَفَّارَةُ أَيْمَانِكُمْ إِذَا حَلَفْتُمْ وَاحْفَظُوا أَيْمَانَكُمْ كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ آيَاتِهِ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ

“Allahu nuk ju kërkon juve llogari për betimet e paqëllimta, por ju kërkon llogari për betimet që i bëni me qëllim. Shlyerja e gjynahut për thyerjen e betimeve është: ose ushqyerja e dhjetë të varfërve me mesataren e ushqimit të familjes suaj, ose t’i vishni ata, ose të lironi një skllav. Ai që nuk gjen mundësi për këto, le të agjërojë tri ditë. Kjo është shlyerja për thyerjen e betimeve tuaja, nëse betoheni. Ruajini betimet tuaja!

Kështu jua shpjegon Allahu fjalët dhe ligjet e Veta, që të jeni mirënjohës.”⁴⁴

Ky ajet përmban disa gjykime në lidhje me këto lloj betimesh:

Gjykimi i parë: Nuk ka përgjegjësi për betimet e paqëllimta

Allahu i madhëruar për t'i lehtësuar robtë e Tij e ka hequr për ta përgjegjësinë e betimeve të paqëllimta, të cilat janë ato betime që thuhet nëpër biseda nga nxitimi dhe pa u menduar mirë, siç thoshte Aishja -radiallahu anha-: *“Janë për qëllim fjalët e burrit: Jo, pasha Allahun! Dhe: Patjetër, pasha Allahun!”*⁴⁵

Kjo sepse këto betime janë të shpeshta në gojët e besimtarëve dhe nëse ata do të mbanin përgjegjësi për to do të ishte shumë e mundimshme për ta.

Në gjykimin e betimeve të paqëllimta futen edhe betimet e gabuara p.sh.: kur dikush e mendon një gjë në një formë dhe ajo në realitet është ndryshe, apo betimet në momente zemërimi kur njeriu nuk e logjikon atë që thotë, apo betimet që shkelen nga harresa, veprim për të cilin Allahu i madhëruar e ka larguar përgjegjësinë siç është përmendur nga shumë prej komentuesve të Kuranit⁴⁶.

44 Suretu El-Maide: 89.

45 E transmeton Buhariu.

46 Shih tefsirin e Taberit: 4/427-449.

Kështu njerëzit për këto betime nuk kanë përgjegjësi çka do të thotë se atyre, as nuk u kërkohet medoemos t'i zbatojnë ato dhe as u kërkohet t'i shlyejnë në rast të shkeljes së tyre.

Gjykimi i dytë: Betimet e qëllimta duhen ruajtur

Betimet e qëllimta janë ato betime pas të cilave është kapur fort zemra, gjë e cila tregon se i betuari e ka dashur betimin dhe për këtë arsye ato duhen ruajtur sepse siç thamë më lart ato janë madhërime për Allahun e lartësuar.

Përgjegjësia për betimet e qëllimta ndryshon sipas veprave për të cilat është bërë betimi, kështu që kemi disa raste betimesh:

Rasti i parë: Kur vepra për të cilën është betuar dikush është detyrë prej Allahut të madhëruar.

Kur veprat në origjinë janë detyrë prej Allahut të madhëruar, atëherë betimi i besimtarit për kryerjen e tyre është forcim i përgjegjësisë së tij.

Shejhu i Islamit Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë- thotë:

“Ai që betohet për të bërë një vepër e cila është detyrë për të si: namazi, zekati, agjërimi, haxhi, mirësia ndaj prindërve, mbajtja e lidhjeve farefisnore, bindja ndaj prijësit dhe këshillimi i tij, apo heqja dorë nga kryengritja dhe luftimi i tij, shlyerja e një borxhi të marrë, dhënia e të drejtave atyre që u takojnë, pengimi i padrejtësive dhe largimi nga moralet e ulta etj., të

*gjitha këto vepra para betimit janë detyrë dhe ato pas betimit janë detyrë më e fortë. Po ashtu edhe ajo punë e cila para betimit është e ndaluar pas betimit bëhet akoma më shumë e ndaluar.*⁴⁷ Mbaron këtu fjala e tij.

Kështu nëse këto detyra para betimit nuk duhen neglizhuar, atëherë aq më tepër pas betimit, sepse betimi e ka shtuar përgjegjësinë ndaj tyre. Shejhu i Islamit Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë- përsëri citon:

*“Çdo akt përmbushja e të cilit është detyrë pa betim, nëse betohet për të, atëherë betimi është forcim i përgjegjësisë ndaj nuk lejohet prishja e tij, madje është përmendur në hadithet e sakta nga profeti -alejhi selam- se ka thënë: **Katër cilësi kush i ka është plotësisht hipokrit (munafik) dhe kush ka njëren prej tyre ka një cilësi të hipokritit derisa ta lërë atë: kur flet gënjen, kur i besohet diçka nuk e ruan, kur e jep fjalën e shkel dhe kur debaton shpërthen.***^{48”49}.

Pra, thyerja e betimit në këtë rast është hipokrizi dhe në lidhje me të nuk bëhet fjalë për shlyerje me dëshirë të betimeve, veçse nëse besimtarit në momente dobësie i bie vullneti dhe e shkel betimin, atëherë ai duhet të pendohet për këtë cilësi dhe pastaj ta shlyej betimin e tij siç thonë disa dijetarë⁵⁰, pastaj të angazhohet përsëri në kryerjen e

47 Shih fjalët e autorit të libri “Mexhmu El-Fetaua”: 33/145.

48 E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

49 Shih fjalët e autorit të libri “Mexhmu El-Fetaua”: 33/146.

50 Shih çfarë thotë imam Neveviu -Allahu e mëshiroftë- në librin e tij Raudatu Et-Talibijn: 20/11.

detyrave, sepse ato vepra janë detyra me porosinë e Allahut të madhëruar pavarësisht nga betimi i tij.

Rasti i dytë: Kur vepra për të cilën është betuar dikush është punë e lejuar (d.m.th. jo detyrë dhe as e ndaluar).

Kur veprat në origjinë janë punë të lejuara prej Allahut të madhëruar, atëherë betimi i besimtarit për kryerjen e tyre është forcim i vullnetit të tij për përfshirjen e tij në ato punë. Nëse ato vepra janë punë që përmbajnë mirësi të cilat i do Allahu i madhëruar si lëmosha, apo kurban, apo namazi vullnetar, apo ndihmesa e të tjerëve etj., atëherë ato është më mirë të mbahen se sa të shlyhet betimi, sepse profeti -alejhi selam- thotë: **“Kush zotohet për t’iu bindur Allahut t’i bindet atij.”**⁵¹

E nëse ato vepra për të cilat betohet përmbajnë pengim nga veprimi i këtyre mirësive, atëherë betimi është më mirë të shlyhet, sepse Allahu i madhëruar thotë:

وَلَا تَجْعَلُوا اللَّهَ عُرْضَةً لِأَيْمَانِكُمْ أَنْ تَبَرُّوا وَتَتَّقُوا وَتُصْلِحُوا بَيْنَ النَّاسِ
وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

“Mos e bëni betimin në Allah pengesë për kryerjen e veprave të mira, largimin prej të ligave dhe për pajtimin e njerëzve! Allahu i dëgjon dhe i di të gjitha.”⁵²

Kështu ka vepruar Ebu Bekri -radiallahu anhu- në lidhje me një sahabi që quhet Mistah i cili i kishte përfolur bijën

51 E transmeton Buhariu.

52 Suretu El-Bekara: 224.

e tij Aishen -radiallahu anha-. Kur u qartësua në Kuran se Aishja ishte e pafajshme, atëherë Ebu Bekri u betua se nuk do ta ndihmonte më Mistahun. Më pas zbritën disa ajete Kurani ku Allahu thotë:

وَلَا يَأْتَلِ أُولُو الْفَضْلِ مِنْكُمْ وَالسَّعَةِ أَنْ يُؤْتُوا أُولِي الْقُرْبَىٰ وَالْمَسَاكِينَ وَالْمُهَاجِرِينَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلْيَعْفُوا وَلْيَصْفَحُوا أَلَا تُحِبُّونَ أَنْ يَغْفِرَ اللَّهُ لَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ

“Njerëzit e ndershëm dhe të pasur ndër ju të mos betohen se nuk do t’u japin të afërmve, të varfërve dhe mërgimtarëve në rrugën e Allahut; le t’i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë, a nuk doni ju që t’ju falë Allahu? Allahu është Falës e Mëshirëplotë.”⁵³

Atëherë Ebu Bekri -radiallahu anhu- tha: *Po, pasha Allahun, dua të më falë Allahu! Ai ia vazhdoi atij ndihmën dhe e shleu betimin*⁵⁴.

E nëse ato vepra nuk përmbajnë mirësi dhe as pengim mirësish, atëherë i betuari, edhe mund ta mbajë betimin, edhe mund ta shlyej atë nëse e sheh se shlyerja është më e mirë për të, sepse profeti -alejhi selam- thotë: **“Nëse betohesh për ndonjë gjë dhe pastaj e sheh se tjetra është më e mirë se ajo atëherë shlyeje betimin tënd dhe bëje atë më të mirën.”⁵⁵**

⁵³ Suratu En-Nur: 22.

⁵⁴ E transmeton Bejhakui.

⁵⁵ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Rasti i tretë: Kur vepra për të cilën është betuar dikush është punë e ndaluar.

Kur veprat në origjinë janë punë të ndaluara prej Allahut të madhëruar si p.sh.: prerja e lidhjeve farefisnore, apo vrasja e tjetrit etj., atëherë betimi i besimtarit për kryerjen e tyre nuk ndryshon gjë nga origjina e këtyre veprave.

Profeti -alejhi selam- thotë: **“Nuk ka zotime dhe betime, as për çfarë nuk e ke në pronësi, as për kundërshtime dhe as për shkëputjen e lidhjeve farefisnore.”**⁵⁶

Dhe thotë gjithashtu: **“Kush zotohet për ta kundërshtuar atë (Allahun), të mos e kundërshtojë Atë!”**⁵⁷

Madje ky veprim në një hadith tjetër është quajtur punë për shejtanin dhe jo punë për Allahun siç tregon Ibn Abasi -radiallahu anhu- se profeti -alejhi selam- ka thënë: **“Zotimet për të kundërshtuar Allahun janë për shejtanin dhe nuk kërkohet për to zbatim. Ato shlyhen si shlyerja e betimit.”**⁵⁸

Shejhu i Islamit Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë rast betimi thotë: *“Nëse ajo punë për të cilën është betuar dikush përmban lën timer të një detyre apo veprimin e një të ndaluare, atëherë nuk lejohet zbatimi i saj sipas mendimit të të gjithë dijetarëve, dhe bëhet detyrë shlyerja e betimit të shumica e tyre.”*⁵⁹

56 E transmeton Nesai dhe e saktëson shejh Albani.

57 E transmeton Buhariu.

58 E transmeton Bejhakiu dhe e saktëson shejh Albani.

59 Shih fjalët e autorit në librin “Mexhmu el-Fetaua”: 35/253.

Gjykimi i tretë: Mënyra e shlyerjes së betimeve

Në këtë ajet ka gjithashtu qartësim të plotë edhe për mënyrën e shlyerjes së betimeve, rregull me të cilin është veçuar ky ymet siç thotë shejhul-Islam Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë-: *“Kur në ligjet e mëparshme të Allahut (d.m.th. ligjet para islamit) nuk kishte shlyerje, betimi e bënte detyrë zbatimin e veprës për të cilën janë betuar dhe prandaj Allahu i madhëruar e urdhëroi Ejubin -alejhi selam- të marrë tufë fijesh (bistaku i frutave të palmës) për të gjuajtur me to dhe të mos e thyej betimin e tij, sepse ai nuk kishte në ligjin e tij shlyerje betimi. Sikur ai të kishte pasur një gjë të tillë do ta kishte më të lehtë ta bënte atë se sa të ndëshkonte gruan e tij qoftë edhe me një tufë fijesh.”*⁶⁰

Shlyerja e betimeve në islam sipas ajetit të lartpërmendur është me një nga këto veprime:

Ose ushqyerja e dhjetë të varfërve me mesataren e ushqimit që përdor i betuari për familjen e tij, ose veshja e tyre, ose lirimi i një skllavi nga skllavëria. Nëse i betuari nuk ka mundësi për ndonjërin nga këto të treja, atëherë ai duhet të agjërojë tri ditë në kompensim të saj. Përderisa në kohët e sotme skllavëria nuk është e pranishme, atëherë mbetet vetëm e drejta për të zgjedhur mes dy të parave: ose ushqimi i dhjetë të varfërve, ose veshja e tyre.

Të varfërit siç thotë shejhu i Islamit Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë-: *“Janë ata të cilët nuk e sigurojnë dot*

60 Shih fjalët e autorit në librin “Mexhmu el-Fetaua”: 33/148.

mjaftushmërinë dhe kush është kështu prej myslimanëve e meriton të përfitojë prej sadakave.”⁶¹

Pra, ai i cili nuk ka mjaftueshmëri në të ardhurat e tij dhe gjithmonë mbetet peng i nevojës, atij i jepet nga mesatarja e ushqimit apo e veshjes me të cilat ushqen apo vesh i betuari familjen e tij, siç ka ardhur nga të parët e këtij ymeti në lidhje me mesataren e tyre: një vakt me buke e qumësht, ose bukë me gjalp, ose bukë me vaj ulliri, ose bukë me uthull, ose bukë me mish, ndërsa në lidhje me veshjen thoshin: ajo veshje që të mundëson faljen e namazit (d.m.th. këmishë dhe pantallona). Ky ka qenë zakoni i tyre në lidhje me shlyerjen e betimeve dhe është një shembull i mirë për ne për të shlyer betimet tona në kohën tonë.

Pastaj ajeti përfundon me porosinë **“Ruani betimet tuaja! Kështu jua shpjegon Allahu fjalët dhe ligjet e Veta, që të jeni mirënjohës.”**, çka do të thotë se sipas ligjeve të islamit edhe shlyerja e betimit është prej ruajtjes së tyre me përjashtim të rastit kur vepra për të cilën është betuar njeriu në origjinë është detyrë prej Allahut -siç u tha më lart- sepse ajo në këtë rast nuk varet nga betimi. Pastaj kjo gjë e shtynë besimtarin të jetë mirënjohës i Zotit të tij i cili ia ka sqaruar atij fenë dhe e ka udhëzuar atë për devotshmëri siç edhe është kujdesur për të, që në rregullat e saj t’ia largojë atij mundimet dhe vështirësitë “Uel-Hamdulilahi Rabil-Alemijn” dhe lëvdatat i takojnë Allahut, Zotit të botëve!

61 Shih fjalët e autorit në librin “Mexhmu el-Fetaua”: 11/68.

A kërkohet ruajtje për betimet e shirkut?

Ruajtja e betimeve kërkohet vetëm për betimet në Zot, sepse ato janë betimet e respektuara në ligjet e Allahut. Ato respektohen edhe kur përmbajnë diçka të ndaluar -siç u tha më lart- dhe detyra në këtë rast është shlyerja e betimit dhe jo zbatimi, madje ato respektohen edhe nëse dikush e ka bërë atë betim para përqaimit të islamit siç ka ardhur në hadith se Omeri -radiallahu anhu- e ka pyetur profetin -alejhi selam-: “*O i dërguari i Allahut! Unë në kohën e injorancës jam zotuar se do të ngujohem një natë në xhaminë e Qabes (për të adhuruar Allahun). Profeti -alejhi selam- i tha: “Përmbushe zotimin tënd!”*”⁶²

Imam El-Khattabij komentuesi i njohur i haditheve profetike në lidhje me këtë hadith thotë: “*Ky hadith tregon se zotimet e kohës së injorancës, nëse përputhen me rregullat e Islamit, zbatohen.*”⁶³

Ndërsa betimet e shirkut nuk janë betime të respektuara, çfarë do të thotë se nuk kërkohet ruajtja e tyre: as përmbushja dhe as shlyerja. Shejhu i Islamit Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë çështje thotë: “*Kush betohet me ndonjë betim si betimet e myslimanëve dhe e thyen atë, i mjafton atij shlyerja e betimit, ndërsa kush betohet me betime shirku si psh: betohet në dheun e varrit të babait, apo në Qabe,*

62 E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

63 Shih fjalët e autorit në librin e tij “Alam El-Hadith”: 2/990.

apo në bamirësinë e prijësit, apo jetën e shejhut, a dikujt tjetër prej krijesave, janë betime të palidhura dhe nuk kërkohet për to shlyerje nëse nuk përmbushen - sipas mendimit të të gjithë dijetarëve.”⁶⁴

64 Shh fjalët e autorit në librin e tij “Mexhmu el-Fetaua”: 33/59.

4

RREGULLI I KATËRT: PËRMBUSHJA E BETIMEVE TË KËRKESAVE

Betimet e kërkesave janë të kërkojë dikush me betimin e tij në Zot, një veprim nga një tjetër. P.sh.: Pasha Allahun, do vish tek unë sot! Apo: Pasha Allahun, do hamë drekë bashkë!

Këto betime, zbatimi i tyre varet nga përgjigjja e tjetrit dhe profeti -alejhi selam- në lidhje me këtë çështje ka thënë -siç tregon El-Bera bin Azib radiallahu anhu-: “*Na ka porositur profeti -alejhi selam- për shtatë gjëra: ndjekjen e xhenazes, vizitën ndaj të sëmurit, përgjigjen e ftesës, ndihmën e atij që i është bërë padrejtësi, përmbushjen e betimit të tjetrit dhe duaia për atë që teshtin.*”⁶⁵

Njëra prej këtyre porosive të profetit -alejhi selam- është pikërisht përmbushja e betimit të tjetrit dhe është moral i lartë profetik. Imam El-Khattabij -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë hadith thotë: “*Përmbushja e betimit të tjetrit është e pëlqyeshme. Nëse dikush i betohet dikujt për një punë e cila nuk është e keqe dhe as nuk e rëndon atë, atëherë ai duhet t’ia përmbushë atij betimin dhe kjo është prej moraleve të larta.*”⁶⁶

65 E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

66 Shih librin e autorit me titull “Sherh Sahih El-Bukharij”: 3/238.

Ky lloj betimi nëse nuk përmbushet nga tjetri, duhet të shlyhet nga ai i cili është betuar, sepse betimi është i tij dhe jo i tjetrit, pavarësisht se varet nga puna e tjetrit. Shejhu i Islamit Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë- mendon se ky betim duhet të shlyhet vetëm në rastin kur ai betohet dhe e di se tjetri nuk do t'i bindet, sepse nëse e mendon se tjetri do t'i bindet dhe pastaj ndodh e kundërta, atëherë ai nuk ka përgjegjësi për betimin e tij, sepse e ka menduar atë gabim dhe veprimi i tij në këtë rast është si betimet e paqëllimta⁶⁷.

Është edhe një shprehje tjetër e ngjashme me shprehjet e lartpërmendura, por që nuk konsiderohet betim. Ajo është shprehja: Pash Allahun, ma bëj këtë nder! Apo: Pash Allahun ma jep atë gjë! Kjo shprehje edhe pse i ngjan atyre që u përmenden më lart nuk është betim, por vetëm kërkesë në emër të Allahut. Është si shprehja: Për hir të Allahut, ma jep atë gjë! Shejhu i Islamit Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë çështje thotë: *“Shprehja: “Ta kërkoj për hir të Allahut ta bësh këtë gjë.” është lutje dhe jo betim. Ajo është përmendur në hadith “Kush ju kërkon një gjë për hir të Allahut, jepjani!”⁶⁸ dhe nuk kërkohet për të shlyerje nëse tjetri nuk i përgjigjet kërkesës së tij”⁶⁹.*

67 Shih fjalët e autorit në librin me titull “Mexhmu El-Fetaua”: 33/209.

68 E transmeton Ebu Daudi, Nesai, Ahmedi etj dhe e saktëson shejh Albani.

69 Shih fjalët e autorit në librin me titull “Mexhmu El-Fetaua”: 1/206.

SHQIPTARËT DHE BETIMET

Pasi paraqitëm betimet e arabëve para Islamit për të parë se çfarë shoqërie njerëzore kuroi feja e Allahut, pastaj betimet në Islam dhe rregullat e tyre, është radha të flasim për popullin tonë dhe gjendjen e tyre në lidhje me këtë çështje.

Edhe shqiptarët si çdo popull tjetër kanë në shprehjet e tyre betime të cilat vijnë si nevojë e komunikimit të përditshëm midis njerëzve. Ata në shprehjet e tyre kanë edhe betime të pastra në Zot siç ishte zakoni i profetëve, edhe betime shirku dhe idhujtarie të cilat tregojnë për mbeturina të paganizmit.

Betimet e pastra

Betimet e pastra janë betimet në Zot apo betimet në ndonjë prej emrave të Tij si: Allahu, Krijuesi, Dhuruesi, Furnizuesi etj. Betimet në Zot i gjen kudo në Shqipëri, si mes myslimanëve ashtu edhe mes të krishterëve. Ato vijnë si rezultat i kontaktit të shqiptarëve me mësimet e profetëve të cilët nuk kanë pasur në shprehjet e tyre betim tjetër veç betimit në Zot dhe kjo për dy arsye:

E para: Zoti në mësimet e profetëve ishte gjëja më e shtrenjtë dhe betimet pikërisht këtë synojnë: thënien e se vërtetës, apo mbajtjen e premtimit duke u betuar në më të shtrenjtën.

E dyta: Betimet në ligjet e profetëve janë madhërime dhe ata duke qenë se ishin dërguar me njësimin e Zotit dhe vetëm adhurimin e Tij, nuk mund t’ia kushtonin këto madhërime veçse Zotit të tyre.

Kontaktet e shqiptarëve me këtë zakon të profetëve janë nëpërmjet krishterimit dhe nëpërmjet islamit dhe nuk njihet në historinë e dokumentuar të popullit tonë ndonjë kontakt tjetër me zakonet e tyre. Jemi njoftuar në Kuran se në çdo popull është dërguar një profet lajmëtar, mirëpo kjo duhet të ketë qenë në historinë e hershme para Ibrahimit -alejhi selam-, sepse pas Ibrahimit -alejhi selam- të gjithë profetët e dërguar kanë qenë nga familja e tij prej së cilës rrjedhin arabët dhe hebrenjtë dhe ky është shkaku se pse gjurmët e monoteizmit në historinë e dokumentuar të njerëzimit vijnë vetëm nga lindja.

Në betimet e shqiptarëve në Zot dhe veçanërisht myslimanëve prej tyre është shumë i njohur betimi në një emër të veçantë të Tij **“Allahu”**.

Emri **“Allah”** me të cilin i kanë thirrur profetët Zotit të madhëruar dhe gjithashtu janë betuar në të, është emër shumë i vjetër. Ai shfaqet si në gjuhen arabe, gjuha e profetit tonë Muhamed -alejhi selam- dhe në betimet e tij, ashtu edhe në gjuhen hebraike -gjuha e profetëve të bijve të Izraelit-. Ky emër në këtë gjuhë është afërsisht me të njëjtat germa dhe me të njëjtin tingull **“Alohim”**.

Shejh dr. Muhamed Tekiudin El-Hilalij -Allahu e mëshiroftë- (dijetar i njohur i gjuhës arabe, fesë islame dhe

me njohuri të gjera në fushën e linguistikës dhe zotërues i disa gjuhëve të huaja) në lidhje me këtë çështje thotë: *“Kushdo që ka mësuar sado pak nga gjuhët samite të cilat janë simotra të gjuhës arabe, nuk ka për t’iu sosur çudia nga debati rreth emrit Allah, a është emër i parmë (strukturë e ngurtë) apo i prejardhur, ka për ta kuptuar se ai debat është i kotë dhe ka për të gjykuar me plot siguri dhe aspak dyshim se emri i shtrenjtë Allah është i parmë dhe larg prejardhjes, sepse ai me këtë tingull është në të gjitha gjuhët samite. Në gjuhen asiriane: **Alaha**. Banorët e anës së lindjes prej tyre e shqiptojnë: **Alabu**. Kështu është në të tre gjuhët me shkronjën A dhe në hebraisht është **Alohim**. Gjuhët e popujve samitë nuk kanë dallime në lidhje me këtë emër të nderuar.”*⁷⁰

Studiuesi do të thotë se emri Allah është emër i parmë i Allahut dhe për këtë shkak e gjen atë në të gjitha gjuhët e popujve të lindjes të cilët kanë njohur profetët e Allahut. Prandaj këtij emri duhet t’i kushtohet një rëndësi e veçantë, sikurse edhe betimet në Zot apo në Allah duhen ruajtur, sepse është betim i pastër monoteizmi dhe traditë e trashëguar nga profetët e Allahut.

Betimet e shirkut

Betimet e shirkut dhe të idhujtarisë janë betimet në gjëra të shenjta veç Allahut, apo të shtrenjta. Edhe këto betime

70 Shih artikullin e shejh dr. Muhamed Tekiudin El-Hilali -Allahu e mëshiroftë- me titull: Ma ueka’ fil-Kurani bigajri lugatil-arab.

janë të njohura mes shqiptarëve dhe të shpeshta në shprehjet e tyre.

Betimet në gjëra të shenjta janë:

1- **Betimet në idhuj**

Betimet në idhuj janë betimet e hershme të kohës pagane si betimet në Tokën, Qiellin, Malet, Fushat, Ujin, Zjarrin, Gurin, Diellin, Hënë, Yjet etj..

Shqiptarët në kohët e hershme i besonin këto emërtime -si shumë popuj të tjerë të rajonit- për zota dhe betoheshin në to gjithashtu. Këta popuj mbetën në injorancë dhe paganizëm edhe pse Allahu i madhëruar ka dërguar në çdo popull profet -siç u tha më lart-. Shejhu i Islamit Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë- kur flet për filozofët e Greqisë të cilët edhe pse kanë qenë pas Ibrahimit, Musait etj. nuk kanë njohur profetët dhe udhëzimet e tyre, thotë: “*Kjo dukuri ka dy përgjigje:*

*E para: Shumica prej tyre nuk i kanë njohur profetët, sepse siç thotë Allahu i madhëruar në Kuran: “Ne kemi dërguar te çdo popull një të dërguar që t’ju thotë: adhuroni Allahun dhe largojuni idhujtarisë! Prej tyre kishte që i udhëzoi Allahu dhe prej tyre kishte që shkuan në humbje, prandaj udhëtoni në tokë dhe shihni përfundimin e përgënjeshtresve.”*⁷¹

71 Suratu El-Nahl: 36.

Kështu ata që zgjodhën kundërshtimin e profetëve nuk u mbetën më pas, as lajmet e profetëve dhe as fjalët e tyre.

E dyta: Fjala e Allahut “Pasha Allahun, kemi dërguar lajmëtarë te popujt para teje, por Shejtani ua zbukuroi punët (e këqija) dhe ai sot është kujdestari i tyre.”⁷²

Kështu, kur Shejtani ua zbukuroi atyre punët e këqija, pati prej tyre popuj që i humbën gjurmët e profetësisë.”⁷³

Pra, shejhu i Islamit Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë- shpjegon se ata janë lajmëruar me fenë e drejtë, por i humbën gjurmët e saj: ose për shkak se ata kundërshtuan profetët e Allahut dhe qëndruan në injorancë, ose për shkak se Shejtani pas profetëve ua zbukuroi të keqen dhe ata kaluan nga dija në injorancë.

Betimet pagane vazhdojnë akoma të jenë të pranishme te shqiptarët, veçanërisht te banorët e vendeve malore dhe duhen luftuar që të pastrohen shprehjet e njerëzve prej shirkut dhe idhujtarisë.

2- Betimet në shenjtorë

Betimet në shenjtorë -siç besojnë disa prej njerëzve- janë betimet në: Krisht, baballarë, dervishë etj.

Betimi në Krisht, apo Isai -alejhi selam- siç njihet te myslimanët gjendet te besimtarët e krishterë, ndërsa betimi në baballarë e dervishë gjendet tek disa sekte që kanë lidhje me islamin. Kjo traditë për fat të keq i është bashkangjitur

⁷² Suretu En-Nahl: 63.

⁷³ Shih fjalët e autorit në librin En-Nubuat: 1/196-197.

fesë edhe pse siç u tha më lart te profetët nuk është njohur veçse betimi në Zotin e tyre. Ajo ka hyrë te shqiptarët për shkak të ndryshimeve që kanë pësuar mësimet e profetëve në periudha të ndryshme kohore pas largimit të tyre. Ja çfarë thotë Ibn Kethiri -Allahu e mëshiroftë- prej komentuesve më të mëdhenj të Kuranit dhe një ndër historianët më të njohur të islamit- në lidhje me ndryshimet që kanë pësuar mësimet e profetit Isa -alejhi salam-.

Ai thotë: *“Romakët të cilët quhen ndryshe edhe të verdhët (ndoshta për shkak ngjyrës së flokëve) kanë qenë në fenë e grekëve. Grekët rrjedhin nga Jafith i biri i Nuhut dhe janë bij xhaxhallarësh me turqit. Ata adhuronin shtatë planetet lëvizëse (Dielli, Hëna, Jupiteri, Mërkuri Saturni, Venusi dhe Marsi) të cilat quhen gjithashtu planetet e hutuara (sepse ndryshojnë trajektoren e tyre) dhe faleshin në drejtim të polit të veriut. Ata kanë themeluar Damaskun dhe kanë ndërtuar faltoren e saj me dhoma të drejtuara nga veriu dhe kanë qenë në fenë e tyre deri treqind vjet pas Mesihut. Sundimi i Shamit dhe Mesopotamisë ka qenë i tyre dhe sunduesi quhej Çezar. I pari që ka përqafuar krishterimin prej tyre ka qenë Kostandini i biri i Kostasit dhe nëna e tij Maria Helena e Shedkanit nga Harrani (vend mes Sirise dhe Turqise sot). Ajo kishte përqafuar krishterimin para tij dhe e ftoi atë në krishterim. Ai më përpara ishte filozof dhe pastaj ndoqi nënën e tij dhe thuhet se e bëri këtë gjë për hipokrizi. Të krishterët u bashkuan me të dhe kanë debatuar shumë në kohën e tij me Arjusin (prift i cili mohonte anën hyjnore të Mesihut -alejhi salam-) dhe*

ranë në kundërshtime të mëdha, mirëpo një grup prej tyre afërsisht treqind e tetëmbëdhjetë veta i shkruan Kostandinin librin e besimit të cilën e quajtnë amaneti i madh (formula e pagëzimit)...”⁷⁴. Pastaj thotë: “Ky perandor është ai që e ka tjetërsuar fenë e Mesihut duke shtuar dhe pakësuar dhe për hir të tij janë vendosur ligjet dhe amaneti i madh... Në kohën e tij është lejuar mishi i derrit, janë falur në drejtim të lindjes, i kanë zbukuruar kishat me ikona dhe kanë shtuar në agjërimin e tyre dhjetë ditë për shkak të një gabimi që kishte bërë dhe kështu u bë feja e Mesihut feja e Kostandinin.”⁷⁵

Edhe ndryshimet në Islam pothuajse kanë ndodhur në të njëjtën mënyrë, nga njerëzit që vinin nga popuj që nuk kanë njohur librat e Allahut si persët, indianët dhe nga literatura filozofike greke të cilët mbartnin pikëpamje të gabuara besimi jashtë udhëzimeve profetike. Ata më vonë u bënë shkak për futjen e atyre pikëpamjeve të gabuara edhe në besimin e pastër të profetit Muhamed -alejhi salam- dhe formimin e disa sekteve si p.sh.: sufitetë të cilët janë të njohur për shenjtërimin e individit. Ja çfarë thotë një studiues egjiptian në lidhje me ndikimin e sufive në besimin e njerëzve.

Ai thotë: “Shkon burri te kadiu (gjykatësi) dhe ai i thotë (për ndonjë çështje që kërkohet betim): Betohu në Zot! Dhe ai betohet sa të dojë: një herë, dy herë, tri herë, katër herë etj. Pastaj kadiu i thotë: betohu në Bedeviun (një prej shenjtëtorëve

74 Shih tefsir Ibn Kethir: 6/301.

75 Shih tefsir Ibn Kethir: 2/48.

të sufive) se nuk e ke bërë filan gjë! Dhe ai i thotë: Jo. Dridhet para tij dhe nuk betohet në Bedeviun. Kjo gjendje tregon se ai i frikësohet Bedeviut më shumë se Allahut dhe detyrimisht e madhëron atë më shumë se Allahun.”⁷⁶

Ja se çfarë bëjnë sektet e devijuara me njerëzit! Ata më shumë kanë kultivuar tek ata kultin e individit sesa madhërimin e Zotit dhe frikën prej Tij!

Edhe kjo dukuri gjendet në mesin e shqiptarëve myslimanë dhe të krishterë, por dallimi mes myslimanëve dhe të krishterëve është se mes myslimanëve gjithmonë ka pasur dhe do të ketë njerëz që i kritikojnë dhe i luftojnë këto dukuri siç thotë shejhu i Islamit Ibn Tejmije -Allahu e mëshiroftë-: “*Muslimanët edhe pse në mesin e tyre kanë pasur njerëz që kanë bërë ndryshime dhe devijime në fe, mirëpo shumica e tyre i kanë refuzuar ato, sepse profeti -alejhi selam- ka thënë: “Ka për të mbetur mes ymetit tim një grup fitimtar në të vërtetën, të cilëve nuk do t’ju bëjnë dëm ata që i kundërshtojnë dhe as ata që i braktisin deri në ditën e fundit të dynjasë.”*⁷⁷⁷⁸

3- Betimet në objekte të shenjta

Betimet në objekte të shenjta janë betimet në: kisha,

⁷⁶ Shih shpjegimin Ed-Durr En-Nedid të Muhamed Hasen Abdul-Gaffar.

⁷⁷ E transmeton Muslimi.

⁷⁸ Shih librin e autorit me titull El-Xheuab Es-Sahih: 2/413.

kryqe, varre, tyrbe, teqe etj. Edhe këto betime gjenden tek shqiptarët, si tek të krishterët ashtu edhe tek disa prej sekteve që kanë lidhje me islamin. Ato vijnë -siç u tha më lart në lidhje me individin- nga ndjekja e zakoneve të paganizmit, sepse shenjtërimi i objekteve është zakoni i vjetër në historinë e njerëzimit. Në këtë zakon ranë popujt paganë para Ibrahimit -alejhi selam-, pastaj ranë hebrenjtë dhe të krishterët para islamit duke ndjekur shembullin e popujve të mëparshëm -edhe pse i njihnin udhëzimet e Allahut- dhe së fundi ranë edhe një pjesë e myslimanëve pas ardhjes së tij. Profeti Muhamed -alejhi selam- në lidhje me shenjtërimin e objekteve thoshte: **“Ata që ishin para jush i merrnin varret e profetëve dhe njerëzve të mirë të tyre faltore. Mos i merrni ato për faltore! Unë ju ndaloj ju nga kjo gjë.”**⁷⁹ dhe ka thënë gjithashtu: **“Dijeni se njerëzit më të këqij të Allahu janë ata që morën varret e profetëve për faltore.”**⁸⁰

Edhe nëse disa objekte kanë rëndësi të vërtetë fetare si Qabeja, xhamia e profetit dhe xhamia e Aksasë, nuk lejohet betimi në to -siç u përmend më lart-, sepse janë madhërim objektesh, aq më tepër nuk lejohet betimi në objekte të tjera që nuk e kanë rëndësinë e tyre, apo ato të cilat çdo gjë rreth tyre është e shpikur si p.sh. çështja e varreve.

Prej gjërave të çuditshme të cilat ndoshta u bëjnë dobi të

79 E transmeton Muslimi.

80 E transmeton imam Ahmedi dhe e saktëson shejh Albani.

krishterëve që betohen në kisha apo edhe disa myslimanëve të paditur shqiptarë të cilët betohen në kisha duke ndjekur të krishterët është edhe fakti se Mesihu -alejhi salam- ka ndaluar nga betimi në qytetin e Jerusalemit siç përmendet në librat e tyre⁸¹. Qyteti i Jeruzalemit është qyteti që përmban faktoren e Daudit -alejhi salam-, apo xhamia e Aksasë siç njihet te myslimanët, atëherë si mund t'u lejohet njerëzve të betohen në objekte çfarëdo qofshin ato?!

Ndërsa betimet në gjëra të shtrenjta janë:

1- Betimet në gjëra të shtrenjta për jetesën si buka dhe kripa.

2- Betimet në njerëz të shtrenjtë si prindërit, vëllezërit, motrat dhe fëmijët.

3- Betimet në cilësi të shtrenjta si nderi, besa, ideali etj.

Edhe këto betime janë të pranishme në shprehjet e shqiptarëve dhe janë mbeturinë e idhujtarisë në të cilën çdo gjë e shtrenjtë adhurohej. Betimet në to kanë qenë edhe tek arabët para islamit siç u tha më lart dhe i ka ndaluar profeti Muhamed -alejhi salam- që të mos madhërohet askush përveç Allahut. Allahu me të vërtetë ka urdhëruar që këto gjëra të shtrenjta të nderohen dhe të respektohen, mirëpo jo të madhërohen deri në atë gradë sa të barazohen me Të. Allahu i madhëruar në Kuran thotë:

81 Shih Ungjilli sipas Metës: 5/34-37.

وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا

“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit.”⁸²

Ky ajet ka sqarim të plotë rreth kësaj çështjeje duke bërë dallim mes adhurimit dhe respektit. Adhurimin e ka kërkuar për veten e Tij, ndërsa respektin për prindërit dhe për çdo gjë tjetër të shtrenjtë. Profeti -alejhi selam-thotë: **“Respektojeni bukën!”**⁸³ po ashtu edhe për besën Allahu i madhëruar thotë: **“Mbajeni besën se për të do të pyeteni!”**⁸⁴. Të gjitha këto janë gjëra të shtrenjta pa të cilat nuk mund të jetohet në tokë, duhen respektuar e nderuar por jo adhuruar si Allahu i madhëruar i cili ka urdhëruar që ato të respektohen. Betimet në gjëra të shtrenjta nuk janë në të njëjtën gradë me betimet në gjërat e shenjtëruara, sepse betimet në këto të fundit përmbajnë nënshtrim ndaj tyre me frikë dhe shpresë dhe prandaj njerëzit edhe u luten atyre dhe janë shirk i madh, ndërsa betimet në gjëra të shtrenjta janë teprim në dashuri dhe nuk përmbajnë nënshtrim, por gjuha duhet të pastrohet prej tyre që adhurimi të jetë vetëm për Allahun e madhëruar.

82 Suratu El-Isra: 23.

83 E transmeton Hakimi, Bejhakui dhe e saktëson shejh Albani.

84 Suratu El-Isra: 34.

Çfarë kërkohet prej Shqiptarëve?

Ajo që kërkohet prej shqiptarëve është lënia e zakoneve të paganizmit dhe kapja fort pas zakoneve të profetëve, sepse në mësimet dhe udhëzimet e tyre është feja e drejtë dhe shpëtimi, siç i ka thënë Allahu i madhëruar profetit të tij të fundit Muhamedit -alejhi selam-:

أُولَئِكَ الَّذِينَ هَدَى اللَّهُ فَبِهِدَاهُمْ أَقْتَدِهِ

“Këta janë ata, të cilët Allahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, andaj edhe ti (o Muhamed) ndiq rrugën e tyre.”⁸⁵

Profetët në zakonet e tyre nuk adhuronin tjetërkënd veç Allahut dhe prandaj ata nuk betoheshin veçse në Të, ndërsa idhujtaria është errësirë e pafundme e mbushur plot me gropa, gjë e cila nuk të jep gjë tjetër veçse humbjen e garantuar. Allahu thotë:

وَمَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَكَأَنَّمَا خَرَّ مِنَ السَّمَاءِ فَتَخْطَفُهُ الطَّيْرُ أَوْ تَهْوِي بِهِ
الرَّيْحُ فِي مَكَانٍ سَحِيقٍ

“Kush i shoqëron Allahut diçka (në adhurim), është sikur po bie nga qielli, pastaj e rrëmbejnë zogjtë, apo e hedh stuhia e erës në një vend të largët e të humbur.”⁸⁶

⁸⁵ Suratu El-En'am: 90.

⁸⁶ Suretu El-Haxh: 31.

Këto zakone profetike, i përfshiu Allahu i madhëruar më pas në Islam, feja e profetit tonë të dashur Muhamedit -alejhi salam- duke bashkuar mes të drejtës dhe të lehtës, siç thotë ai vetë: **“Jam dërguar me fenë e drejtë dhe të lehtë”**⁸⁷.

Feja e drejtë është për nga ana e besimit, sepse ndoqi zakonin e profetëve në adhurimin e Allahut një, Zotit të vetëm të krijesave, ndërsa feja e lehtë është për nga ana praktike me të cilën e ka veçuar Allahu fenë e Muhamedit -alejhi salam- duke e larguar vështirësinë dhe kufizimet e mëparshme, gjë të cilën e pamë edhe tek betimet. Në rregullat e kësaj feje në lidhje me betimet ishte shlyerja e betimeve zakon të cilin nuk e gjen në asnjë udhëzim, qofshin ato të drejta si ato të profetëve para Muhamedit -alejhi salam- apo të shpikura si ato të paganizmit. Sa e sa shqiptarë betohen për ndonjë punë dhe kur më vonë shohin se ato punë mund të jenë të dëmshme, apo mund të mos jenë zgjedhja më e mirë, nuk gjejnë rrugë tjetër veçse t'i thyejnë betimet e tyre.

Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë, siç thotë Allahu i madhëruar në Kuran dhe këto janë betimet e shqiptarëve të peshuara në peshoren e saktë të udhëzimeve të Allahut dhe profetëve të Tij.

87 E transmeton Ahmed i dhe e saktëson shejh Albani.

PSE KJO TEMË?

Ajo që më ka nxitur të shkruaj për këtë temë është një udhëtim që kam bërë në një zonë të Shqipërisë ku betimet e shirkut në shenjtor, apo objekte të shenjtëruara janë shumë të përhapura për shkak të ndikimit të besëtytnive dhe të njerëzve të papërgjegjshëm të cilët duan ta ngrenë për interesat e tyre kultin e individit. Betimet e shirkut te popullsia e thjeshtë janë përhapur shumë kohët e fundit, ndërsa betimet e pastra janë rralluar aq sa nëse nuk e ngremë zërin kundër kësaj dukurie do të zëvendësojnë plotësisht betimin në Zot. Jam gëzuar shumë një herë kur po kthehesha me autobus nga një zonë tjetër e Shqipërisë të cilën kjo dukuri ka filluar ta prekë shumë, kur dëgjova dy të moshuar të betoheshin në Allah. Ata të dy ishin ulur në një ndenjësë dyshe përbri meje dhe siç dukej nga biseda e tyre nuk ishin burrë e grua, por të afërm të njëri-tjetrit. I moshuari donte t'i paguante të moshuarës biletën, ndërsa ajo i thoshte: *“Pasha Allahun, nuk do ta paguash se do ta paguaj vetë.”* Ky betim më gëzoi jashtë mase, sepse është betim i pastër në Zot dhe në emrin më të veçantë të Tij “Allahu” siç ishte tradita e profetëve -alejhim selam-.

Ta dëgjosh këtë betim në këtë kohë dhe në këtë gjendje që janë njerëzit e thjeshtë në ato zona të bën të fluturosh nga gëzimi.

Lus Allahu e madhëruar ta bëjë këtë përpjekje modeste shkak për pastrimin e besimit të njerëzve dhe të shprehjeve të tyre nga shirku dhe idhujtaria! Amin!

